Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

THIRRJE PËR APLIKIM

Përkrahja e Fermerëve në perimtari me serra smart 500m²

Tipi i serrës që mbështetet është:

- Serra e tipit "Tunel", sipërfaqja 500m²
- Serra e tipit "Bllok", sipërfaqja 500m²

Kriteret e përgjithshme:

1. Aplikuesi duhet të ketë pronën në territorin e Komunës së Prishtinës dhe të jetë banor rezident i saj;
2. Fermerët të cilët planifikojnë ngritjen e serrës me sipërfaqe prej 0.05ha, të tipit "Tunel", parcela duhet të jetë minimum e gjate 66.50m dhe minimum e gjerë 12.0m;
3. Fermerët të cilët planifikojnë ngritjen e serrës me sipërfaqe prej 0.05ha, të tipit "Bllok", parcela duhet të jetë minimum e gjate 35.00m dhe minimum e gjerë 20.00m;
4. Fermerët apikues për serrën 0.05ha, duhet të posedojnë së paku një sipërfaqe prej **0.20ha** të pandarë të mbjellura me perime me kulturat (spec,domate,sallatë të gjelbër,tranguj,karrota);
5. Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
6. Fermerët të cilët nuk e kanë pronën në pronësi familjare, por shfrytëzojnë tokë më qira, duhet të kenë marrëveshje kontraktuese të nënshkruar nga të dy palët (të noterizuar), në kohëzgjatje prej 5 vitesh;
7. Fermerët përfitues të serrës gjatë vitit kalendarik 2026 nuk mund të jenë përfitues të serrës 500 m²;
8. Parcela ku planifikohet ndërtimi i serrës duhet të ketë qasje në energji elektrike.

Kriteret specifike:

1. Fermerët me sipërfaqe më të madhe, kanë përparësi në raport me ata që kanë sipërfaqe më të vogël të mbjellë me perime me kulturat (spec,domate,sallatë të gjelbër,tranguj,karrota);
2. Në kushte të barabarta, përparësi përfitimi kanë fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët nuk kanë qenë asnjëherë përfitues të serrave nga komuna dhe donatorët në bashkëpunim me komunën;
3. Njohuritë elementare në fushën përkatëse, (Dëshmi);
4. Fermerët me përgaditje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
5. Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
6. Gratë fermerë dhe grupet e margjinalizuara;
7. Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
8. Prona e marrë me qira;
9. Infrastruktua përcjellëse (burimi i ujit, sistemi i ujitjes, energjia elektrike);
10. Fermerët banorë rezident në vendin ku planifikohet ngritja e serrës;
11. Konfiguracioni i terenit.

Dokumentacioni i kërkuar:

1. Kopja e një dokumenti identifikues të Republikës së Kosovës;
2. Numri identifikues i fermerit (NIF);
3. Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme, jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
4. Kopja e planit të sipërfaqes punuese dhe të parcelës ku planifikohet të ndërtohet serra, jo më e vjetër se 6 muaj;
5. Marrëveshja për marrjen e tokës me qira në mes palëve, atëhere kur fermeri deklaron se aktivitetin e realizon në tokë me qira;
6. Deklarata nën betim.

Aplikimi bëhet nga 19/08/2026 deri 04/09/2026, në objektin e bashkësisë lokale në Besi.

VËREJTJE:

Nëse komisioni parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, qytetari (fermeri) është i obliguar që t'i sjellë ato në afatin i cili i caktohet, në të kundërtën humbë të drejtën për të qenë përfituesi i grantit.

*Aplikimet pas afatit nuk do të merren parasysh.